



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri lëndës: 2021:148657

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06322716

CAP.nr.403/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A.F. nga fshati K., Komuna e Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I. S., avokat në P., kundër debitorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me seli në Prishtinë, Rruga "Armend Daci", Nr. 1, lidhur me çështjen Kundërpërmbartimore, për kthim të mjeteve, në shumë prej 5,000.00 €, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit CP.nr.719/22 i datës 07.02.2023, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ndërsa me datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit A. F. nga fshati K., Komuna e Gj., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, CP.nr.719/22 i datës 07.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, CP.nr.719/22 i datës 07.02.2023, ka vendosur si në vijim: *“HEDHET propozimi për kundër përmbartim CP.nr.719/21, datë 23.12.2022, i ushtruar nga kreditori A. F. nga Gj., kundër debitorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, si i pasafatshëm.”*

Kundër këtij aktvendimi përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që: Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovoj si e bazuar dhe ta prish aktvendim e atakuar ashtu që të lejohet kundërpërmbartimi.

Debitori nuk ka paraqitura përgjigje në ankesë kreditorit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit është e pathemeltë, për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 23.12.2022, ka paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, propozim për kundërpërmbartim, më të cilin ka kërkuar që të anulohet aktvendimi CP.nr.1/13 i datës 03.01.2013, si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CP.nr.719/22 i datës 07.02.2023, e ka hudh si të pasafatshëm propozimin e kreditorit për kundërpërmbartim ndaj debitorit.

Në aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: pas pranimit të propozimit për kundër përmbartim të datës 23.12.2022 dhe vlerësimit të te njëjtit në aspektin e rregullsisë dhe afatshmërisë se tij, bazuar në provat e bashkëngjitura në lëndë, erdhi në përfundim se propozimi për kundër përmbartim është i pasafatshëm. Me nenin 54 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), është përcaktuar se: "Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbartimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbartimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbartimit, në qoftë se: pika 1.1 dokumenti përmbartues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik"; 1.2. aktvendimi apo urdhri për përmbartim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar; 1.3. gjatë kryerjes së procedurave përmbartuese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbartimit dhe kamatat; 1.4. përmbartimi i kryer në një objekt specifik të përmbartimit është i palejuar, tutje në paragrafin 3 të këtij neni parashihet se "Propozimi për kundër përmbartim nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijeni për shkakun e kundër përmbartimit por jo më vonë se një (1) vit, nga dita e përfundimit të procedurës përmbartimore".

Gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh se pretendimet për kundër përmbartim, se kanë qenë të ditura qysh në kohën e paraqitjes se ankesës ndaj aktvendimit CP.nr. 1/13, datë 19.11.2015, duke ju referuar pretendimit lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv. Po ashtu,

referuar pretendimit të kreditorit se mjetet e bllokuara rrjedhin nga pensioni i veteranit të luftës, gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është pretendim i paraqitur pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, marrë parasysh kohën kur ka filluar ekzekutimi i pensioneve të parapara me Ligjin për Veteranet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili ka vite që ka hyrë në fuqi, e përfundimisht fakt i pranuar me ankesën e parashtruar nga vetë kreditori në procedurën sipas shenjës CP.nr.1/13, datë 07.07.2021.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka hudh si të pasafatshëm propozimin për kundërpërmbarrim për arsye se propozimi për kundërpërmbarrim është veprim procedural dhe mund të paraqitet vetëm brenda afatit të paraparë ligjor dhe atë shprehimisht me dispozitat e nenit 54 par. 3 i LPP. Këto rregulla normative vlejné para rregullave të përgjithshme lidhur me afatet për ndërmarrjen e veprimeve procedurale në procedurën përmbarrimore apo edhe kontestimore. Rregullat e përgjithshme lidhur me llogaritjen e afateve nuk janë paraparë shprehimisht për këtë institut juridik, prandaj në këtë rast vlejné rregullat e përgjithshme konform dispozitave të nenit 17 të LPP-së në lidhje me dispozitat e neneve 127 të LPK-së. Me ligj është paraparë shprehimisht se propozimi për kundërpërmbarrim mund të paraqitet vetëm brenda afatit subjektiv ose edhe atij përfundimisht objektiv. Këto afate vlejné në mënyrë alternative dhe jo kumulative, me konsekuencën se nëse ka kaluar afati subjektiv me dijeninë e të legjitimuarit, në këtë rast të kreditori në këtë procedurë, nuk mund të pretendojë, që të paraqet propozim për kundërpërmbarrim edhe nëse është brenda afatit objektiv. Më konkretisht kjo gjykatë vlerëson se kreditori ka qenë në dijeni lidhur më pretendimet për kundërpërmbarrim qysh në kohën kur e ka paraqitur ankesën kundër aktvendimit CP.nr.1/2013 i datës 19.11.2015, që ka pas të bëjë lidhur më legjitimitetin e debitorit në atë procedurë (që në këtë procedurë është kreditor), ndërsa propozimi për kundërpërmbarrim është paraqitur në Gjykatën e shkallës së parë me datë 23.12.2022, apo mbi 7 vite nga koha kur kreditori (në atë procedurë debitor). Ndërsa afati subjektiv për paraqitjen e propozimit për kundërpërmbarrim është 15 ditë nga dita, kur është vënë në dijeni për mundësinë se mund të paraqesë propozimin për kundërpërmbarrim.

Gjykata e Apelit, në këtë rast vlerëson se kreditori, nuk e ka paraqitur propozimin për kundërpërmbarrim brenda afatit subjektiv të lartcekur, që në këtë rast, nga kjo rezulton se kreditori e ka humbur të drejtën e paraqitjes të propozimit, edhe nëse kjo është e mundshme sipas afatit objektiv. Kjo për shkak të faktit se këto afate vlejné në mënyrë alternative. Afati objektiv vlen vetëm atëherë kur fare nuk është shfaqur kondita e krijimit të afatit subjektiv dhe ky afat është një (1) vit, nga dita e përfundimit të procedurës të përmbarrimit. Prandaj, në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt, me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar më ankesë, pasi që në këtë rast kreditori, edhe pse ka qenë në dijeni për shkakun e kundërpërmbarrimit, propozimin për kundërpërmbarrim e ka paraqitur pasi ka kaluar afati më shumë se një vit, prandaj kreditori nuk mund të thirret në afatin subjektiv pas kalimit edhe të afatit objektiv.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera e ankimore të kreditorit, por që të njëjtat në vlerësim të dispozitave ligjore nuk ishin relevante ashtu që të merrej vendim tjetër e që do të ishte në favor të palës kreditore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.403/2023 me datë 16.10.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci